



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 106, Datë 31.05.2024

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S MBI  
KËRKESËN E SHOQËRISË “HYDROBORSH” SH.P.K. PËR MARRJEN E  
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË  
ASETEVE FIKSETË SAJ**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 770/8 prot., datë 29.05.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 56, datë 02.04.2024, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj për të garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj palës kredidhënëse “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a..
- Në vijim të sa më sipër, ERE i’u drejtua shoqërisë me shkresën nr. 770/3 prot., datë 08.04.2024, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe informacionin/dokumentacionit të munguar apo të plotësuar pjesërisht nga ky aplikim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 770/5 prot., datë 25.04.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka nevojë që të sqarohet/depozitohet përsëri dokumentacion për këtë aplikim, ndaj ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 770/6 prot., datë 20.05.2024.
- Në referencë të përcaktimeve të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, dokumentacioni që nevojitet të plotësohet më tej nga shoqëria është si vijon:
  - lista e aseteve të paluajtshme me vlerën e secilit aset dhe vlerën totale, dokument i cili duhet të jetë i nënshkruar nga të gjitha palët që kanë nënshkruar dhe marrëveshjen paraprake të financimit (neni 7, pika 1, gërma “h”);

- *deklarata me shkrim të palës kredidhënëse, “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a., e cila të shprehë gaditshmërinë e saj për të garantuar vijimin e veprimtarisë së licencuar në rast se ndodh transferimi i aseteve (neni 7, pika 1, gërma “i”);*
  - *listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt, nësa ka pasur të tilla (neni 7, pika 1, gërma “j”).*
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 7701/0 prot., datë 30.05.2024 shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit të saj. Në këto kushte dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 2 të Rregullores të sipërcituar dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 67 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësojmë zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k., me 30 (tridhjetë) ditë pune, me qëllim analizimin e dokumentacionit të depozituar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes së bordit mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “HYDROBORSH” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**